



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:235892

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05424587

Në ankesën e

AC-I-23-0227

Paditësi

J V, Gjilan, i përfaqësuar nga B H avokat nga Gjilani.

Kundër

E paditura/Ankuesja

NSH, N.H.N.I "Morava e Binqës"(në likuidim), të cilën e përfaqëson, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami, dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-2726 të datës 20 mars 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 07 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-2726, i datës 20 mars 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 29 tetor 2013, përmes postës paditësi e dërgoi në DHPGJS-ë një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI037-0028, të datës 02 tetor 2013, me të cilën kërkesa e paditësit e datës 21 qershor 2013 për kompensim të tri pagave të pa paguara prej 750.00 euro dhe për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës në shumë prej 1,750.00 euro, refuzohet si e pa vlefshme me arsyetimin se paditësi nuk ka qenë punëtor aktiv, ai nuk ishte në Listën e pagave në muajt e fundit para privatizimit të NSH "Morava e Binqës", andaj nuk i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Autoriteti i Likuidimit po ashtu ka konstatuar se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Në ankesë paditësi ka pohuar se me datë 09 prill 2009, e ka pranuar njoftimin nga AKP-ja për ndërprerjen e marrëdhënies së punës si rezultat i privatizimit të NSH "Morava e Binqës" dhe në këtë njoftim ai ka pohuar se është theksuar se punëtorët do të njoftohen lidhur me kërkesat për pagat e pa paguara pas fillimit të procedurës së likuidimit të NSH-së. Tutje ai pohon se ka bërë kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit me datë 21 qershor 2013, e cila pa ndonjë bazë është refuzuar kinse nuk kam qenë punëtor aktiv dhe nuk kam qenë në Listën e pagave të NSH-së. Tutje paditësi pohon se Autoriteti i Likuidimit gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike dhe gabimisht ka aplikuar dispozitat materiale. Në ankesë paditësi ka kërkuar që të ndryshohet Vendimi i Autoritetit të Likuidimit, dhe atij ti njihet e drejta e kompensimit për shkak të ndërprerjes së parakohshme të Kontratës së punës. Bashkë me ankesë paditësi ka dorëzuar, vendimin e Autoritetit të Likuidimit, dhe Njoftimin e AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 09 prill 2009, një përgjigje të AKP-së të datës 03.05.2011, një kopje të kërkesës për pranimin e përvojës së punës drejtuar AKP-së me 29.03. 2011, një Vendim të NSH-së të datës 03.12.2003, një kopje të padisë të dorëzuar në DHPGJS me datë 17.03.2011, kopjen e Letërnjoftimit, një kopje të Kontratës së punës, dhe kop0jen e Librezës së punës e mbyllur me 27.04.2009.

Me datë 03 shtator 2018, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë mbrojtjen në ankesë në të cilën AKP-ja pohon se e mbështet qëndrimin e Autoritetit të Likuidimit, i cili ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. AKP-ja pohon se vendimi i ankimuar nuk bie ndesh me asnjë dispozitë

ligjore të Ligjit të AKP-së, prandaj nuk ka bazë ligjore të shfuqizohet vendimi i ankimuar. Tutje AKP-ja pohon se NSH "Morava e Binqës" është privatizuar me datë 09 prill 2009, dhe se paditësi nuk ka qenë punëtor aktiv, ai nuk ishte në Listën e pagave në muajt e fundit para privatizimit të NSH "Morava e Binqës", andaj nuk i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Bazuar në këto arsye paditësit nuk i takon e drejta e kompensimit për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës.

Me datë 19 shtator 2018, paditësi e dorëzoi një parashtresë në DHPGJS dhe përgjigjet në mbrojtjen e AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi i kundërshton pretendimet e AKP-së, duke i konsideruara si të pa bazuara në ligj, dhe i përsëritë pretendimet e veta të cekura në ankesë.

Me datë 09 tetor 2018, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS kundërpërgjigjen, në të cilën ajo i përsëritë pretendimet e veta të cekura në mbrojtje në ankesë.

Me datë 20 mars 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, me Aktgjykimin C-IV-13-2726, ankesën e paditësit e aprovon pjesërisht si të bazuar, e ndryshon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, dhe e obligon AKP-në që paditësit në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës, ti paguaj shumën prej 1,750.00 euro, interesin ligjor prej 10%, në shumë prej 175.00 euro, si dhe kompensimi e taksës gjyqësore prej 20 të cilat shuma do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se mes palëve nuk është kontestues fakti se paditësi ishte një punëtor i NSH "Morava e Binqës" mirëpo kontestues paraqitet çështja nëse ai i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së që ti njihet e drejta në kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të Kontratës së punës. E paditura pretendon se paditësi nuk ka qenë punëtor aktiv, ai nuk ishte në Listën e pagave në muajt e fundit para privatizimit të NSH "Morava e Binqës", që ka ndodhë me datë 09 prill 2009. E paditura nuk e kontestuar përvojën e punës të ankuesit që e kishte në NSH. Ankuesi në bazë të Librezës së punës e mbyllur me datë 09.04.2009, dhe Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 09 prill 2009, shihet se ai ka punuar deri në ditën e privatizimit të NSH-së. Tutje shkalla e I-rë konstaton se është aprovuar shuma prej 1,750.00 euro për 7 paga nga 250 euro, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të Kontratës

së punës, duke u bazuar në pagën që ka qenë në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se Gjykata u ka besuar këtyre provave, andaj në bazë të tyre është aprovuar kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës, pasi që me veprimin e AKP-së për shkak të privatizimit të NSH-së, atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës. AKP-ja nuk ka mundur të dorëzojë prova se paditësi nuk ka pas statusin e punëtorit në momentin e privatizimit të NSH-së, dhe në cilën bazë ligjore e ka bërë ndarjen e punëtorëve, në punëtor aktiv dhe pasiv, pasi që asnjë dispozitë ligjore në fuqi nuk parasheh një ndarje të tillë. Shkalla e I-rë konstaton se paditësit i është njohur e drejta në interes ligjor prej 10% në shumë prej 175.00 euro, duke u bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Tutje shkalla e I-rë konstaton se kërkesa për tri paga në shumë prej 750.00 euro është refuzuar, pasi që paditësi nuk ka specifikuar periudhën e këtyre pagave, dhe se kjo kërkesë është refuzuar pasi që nuk është mbështetur as me prova.

Me datë 18 prill 2023, AKP-ja përmes postës e dërgon një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-13-2726 të datës 20 mars 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit si dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes. Tutje AKP-ja pohon se Gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme, njëra që ndërlikohet me afatin për parashtrimin e kërkesave i cili afat i përket procedurës së dorëzimit të dëshmisë së kërkesës dhe afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat e të drejtës e që ka të bëjë me afatin e parashkrimit të kërkesës e që në këtë rast është 3 vite në bazë të nenit 608 të Ligjit të punës së Bashkuar. Tutje AKP-ja pohon se njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës i dërguar tek paditësi ka pas për qëllim të informon atë se ai ka të drejtë të parashtrij kërkesë pranë AKP-së dhe se ky njoftim nuk i mbron të drejtat e tij dhe nuk siguron mjete ligjore që ai ka në dispozicion. Tutje AKP-ja pohon se paditësi nuk ka qenë punëtor aktiv i NSH-së, ai nuk ishte në Listën e pagave në muajt e fundit para privatizimit të NSH "Morava e Binqës", andaj nuk i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Bazuar në këto arsye paditësit nuk i takon e drejta e kompensimit për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës. AKP-ja ka kërkuar që edhe njëherë DHPGJS-

ja të lëshohet në shqyrtimin e çështjes dhe të merren në konsideratë argumentet e Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 14 qershor 2023, paditësi e dorëzoi një parashtresë në DHPGJS dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi i kundërshton pretendimet ankimore të AKP-së duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj dhe e mbështet në tërësi Aktgjykimin e ankimuar të cilin e konsideron si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Paditësi pretendon se në mënyrë të plotë dhe të drejtë është vërtetuar gjendja faktike me provat e administruara nga Shkalla e I-rë dhe gjithashtu në mënyrë të drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale. Paditësi ka kërkuar që të refuzohet ankesa e AKP-së si e pa bazuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet .

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit e datës 21 qershor, e dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës në shumë prej 1,750.00 euro, si dhe kërkesa për kompensim të tri pagave të pa paguara prej 750.00 euro nga NSH "Morava e Binqës" (në likuidim), është refuzuar si e pa vlefshme me arsyetimin se paditësi nuk ka qenë punëtor aktiv, ai nuk ishte në Listën e pagave në muajt e fundit para privatizimit të NSH "Morava e Binqës", andaj nuk i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, si dhe kërkesa për paga është parashkruar në bazë nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e I-rë ka pretenduar se atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës me datë 09 prill 2009, kur është privatizuar NSH-ja. Edhe AKP-ja me mbrojtje në ankesë pohon se NSH "Morava e Binqës" është privatizuar me datë 09 prill 2009, dhe se paditësi nuk ka qenë punëtor aktiv, ai nuk ishte në Listën e pagave në muajt e fundit para privatizimit të NSH "Morava e Binqës", andaj nuk i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e I-rë me datës 29 tetor 2013, ai ka dorëzuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit, dhe Njoftimin e AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 09 prill 2009, një përgjigje të AKP-së të datës 03.05.2011, një kopje të kërkesës për pranimin e përvojës së punës drejtuar AKP-së me 29.03. 2011, një Vendim të NSH-së të datës 03.12.2003, një kopje të padisë të dorëzuar në DHPGJS me datë 17.03.2011, kopjen e Letërnjoftimit, një kopje të Kontratës së punës, dhe kop0jen e Librezës së punës e mbyllur me 27.04.2009.

Në bazë të këtyre dëshmive, mund të konstatohet se paditësi ishte në punë në NSH deri me 09 prill 2009, kur u privatizua NSH-ja.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit konsideron se shkalla e I-rë e DHPGJS-së me të drejtë duke u bazuar në këto prova, e kishte aprovuar ankesën e paditësit si të bazuar dhe e kishte ndryshuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimi, pasi që ai vendim nuk mbështetej në dispozita ligjore.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së duke u bazuar në pagën që ekzistonte në kohën e privatizimit të NSH-së në shumë prej 250 euro ia ka njohur paditësit të drejtën e kompensimit për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës, për 7 paga në shumë prej 1,750.00 euro, ndërsa AKP-ja nuk e ka kontestuar lartësinë e kompensimit.

Paditësit po ashtu i është njohur edhe interesi ligjor prej 10%, në shumë prej 175.00 euro, duke u bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Vendimi i Shkallës së I-rë për refuzimin e kërkesës për tri paga të pa paguara, nuk është ankimuar nga ana e paditësit, andaj Kolegji Apelit nuk do të merr qëndrim ligjor lidhur me këtë pjesë të Aktgjykimit të ankimuar.

Nga këto arsye, ankesa e AKP-së është refuzuar si e pa bazuar, dhe është vërtetuar Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Prandaj nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore me datë 06 qershor 2023, për procedurën ankimore në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 07 mars 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
